

VENDIM
Nr. 759, datë 13.12.2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 822, DATË 19.12.2022,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘NDËRTIMI I LINJËS 110 kV
BURREL–BULQIZË’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 822, datë 19.12.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i linjës 110 kV Burrel–Bulqizë”, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) në pikat 3 dhe 4 vlera “...218 208 (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetë) lekë zëvendësohet me “...228 627.6 (dyqind e njëzet e tetë mijë e gjashtëqind e njëzet e shtatë pikë gjashtë) lekë;

b) tabelës, bashkëlidhur vendimit, i shtohet tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Mat, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Dibër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

TABELA E SHITESAVE NË LISTËN E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE E TË CILËVE SHPRONËSOHEN ME VKM-në NR. 822, DATË 19.12.2022, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “NDËRTIMI I LINJËS 110 kV BURREL–BULQIZË”

NR.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)										VLERËSIMI PËR SHPRONËSIM			Vlera totale	Adresa	SHËNIME: (KUFIZIME HIPOTEKORE, BARRË MBI PASURINË etj.)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati/qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë	Truall	Ndërtesë	Volumi	Faqe	Sipërfaqe shpronësimi (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)			
30	Bedri	Ramazan	Spahiu	Plesh	2990	156/1/27	Arë	6100						91.4	114	10,419.6	10,419.6	Fshati Plesh/Nj.A Klos/Bashkia Klos	Konfirmuar nga ASHK-ja
Vlera Totale																	10,419.6		